



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:010019

Datë: 30.06.2022

Numri i dokumentit: 03188737

CPP.nr.5/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Sh.a KUR "Mitrovica", me seli në Mitrovicë, rruga "B. B.", p.n, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit F. P. nga fshati D. Komuna e V. të ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.1302/21 të datës 13.08.2021, jashtë seance me datën 30.06.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET NË TËRËSI prapësimi i debitorit F.P. nga fshati D. Komuna e V. SHFUQIZOHET Urdhri për Lejimin e Përmbarimit P.nr.1302/21 i datës 13.08.2021.

A r s y e t i m

Kreditori Sh.a KUR "Mitrovica", me seli në Mitrovicë, rruga "B. B.", p.n, me datë 13.08.2021 ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit F. P. nga fshati D Komuna e V. për pagesën e borxhit në emër të shpenzimit të ujit dhe shërbimeve të kanalizimit në shumën prej 517.44 € (pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro e katërdhjetë e katër cent). Përmbaruesi Privat me urdhrin P.nr.1302/21 të datës 13.08.2021 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori F. P. brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi borxhin ndaj kreditorit me arsyetimin se ky borxh është parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, duke propozuar aprovimin e prapësimit dhe anulimin e urdhrorit për lejimin e përmbarimit.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, duke propozuar që prapësimin ta refuzoj në tërësi dhe ta lejoj ekzekutimin e Urdhrit për përmbarim.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar sa i përket borxhit të kreditorit të pretenduar në raport me debitorin, për faktin se borxhi i krijuar nga debitori deri me datë 31.12.2019 është parashkruar, konform nenit 360, par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, ku përcaktohet se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti”*, ndërsa në nenin 360 par.1, nënpar.1.1, të këtij ligji përcaktohet se *“kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj përcaktohet se *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*. Në rastin konkret pasi që kreditori propozimin për përmbarim e ka parashtruar në vitin 2021 dhe e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit nga data 01.01.2020 e deri në kohën e parashkrimit të propozimit datë 13.08.2021, ashtu që borxhi nga data 31.03.2016 e deri me 31.12.2019 në shumën prej 532.47 €, i pretenduar nga kreditori është parashkruar. Ndërsa shuma prej 517.44 € për të cilën është lejuar përmbarimi është borxh që llogaritet në shumën prej 532.47 €, i cili është parashkruar.

Po ashtu, meqenëse u konstatua se gjatë kësaj periudhe nuk ka prova se palët kanë lidhur marrëveshje për riprogramim të borxhit që do të shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit dhe nuk ka prova se kreditori ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor kundër borxhit të debitorit që do të shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit për periudhën gjegjëse kohore, gjykata iu referua aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr. 148/2012, të datës 09.09.2013 (faqja 3, pasuesi i katërt i aktgjykimit), ku parashihet se pagesat eventuale që janë bërë për këtë periudhë nga debitori në formë të ndonjë pagese në këste nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, po që se ato nuk i referohen ndonjë pagese të ndonjë fature fikse për muajin gjegjës, përveç nëse mes palëve ka marrëveshje për riprogramim të borxhit apo ka specifikime të kërkesës për të cilën behet pagesa që në rastin konkret nuk ekzistojnë, e të cilat konform nenit 368, par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, do të rezultojnë me ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit për debitorin.

Pagesat e kohëpaskohshme që debitori ka paguar në emër të borxhit si tërësi nuk nënkupton pohim i borxhit për vet faktin se i njëjti me prapësimin e ushtruar ka kundërshtuar në tërësi borxhin e të njëjtat pagesa nuk janë këste të paguara mbi bazën e ndonjë marrëveshjeje, ashtu që

këto pagesa paushalle nuk kane shkaktuar ndërprerjen e afatit te parashkrimit për debitorin ne rastin konkret.

Pohim indirekt të borxhit, sipas vlerësimit të gjykatës kemi atëherë kur debitori hyn në marrëveshje riprogramimi me kreditorin dhe përcakton afate te reja kohore dhe periodha ne këste te caktuara për përmbushjen e borxhit në tërësi.

Andaj, gjykata bazuar në të lartcekurat dhe në nenin 73 të Ligjit NR. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CPP.nr.5/22, datë 30.06.2022

Gjyqtari
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.